

## Njoftim

Sot, më datë **21.04.2023, ora 18:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Emona Muçi (Anëtare);**
- 5. Manjola Xhaxho (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e godinës “Poli i Drejtësisë”, salla e konferencave të KLGJ-së, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.15 Regj.Themeltar, Datë 20.04.2023 Regjistrimi, me:

**Paditës:** KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

**I paditur:** Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve - (KQZ).

**Person i interesuar:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Indrit Sefa.

**Objekti:** Ndryshimin e Vendimit nr. 61, datë 19.04.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

Ndryshimin e vendimeve nr.361 dhe 362 të KSH, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, si dhe për 60 bashkitë e tjera në vend, duke vendosur përbri emrit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” emrin e z.Sali Berisha.

**Baza ligjore:** Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ; Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH.

me Vendimin Nr. 13, datë 21.04.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

### VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesë padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
4. U shpall në Tiranë më datë 21.04.2023.

**Tiranë, më 21.04.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit**